



Therrija e kurbanit është prej simboleve të dukshme të Islamit, simbol për të cilin mbarë muslimanët janë të pajtuar se është i ligjshëm, kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, vazhdimisht e ka kryer këtë ibadet, siç tregon Enesi, radijall-llahu anhu:

?? ????? ??????? ???????- ?????? ??? ?????? ?????? ????????? ????????? ?????

“Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i mori dy desh me brina dhe të majmë, e i therri me dorë të vet”. (Buhariu).

Në vazhdim do t’i përmendim disa rregulla dhe çështje që kanë të bëjnë me therrien e kurbanit, edhe ate nën këto nëntituj:

Një: Vendimi i sherijatit mbi therrien e kurbanit:

Dijetarët i kanë dy mendime mbi këtë çështje, shumica e dijetarëve thonë se është sunnet i fortë, kurse të tjerët thonë se është vaxhib. I këtij mendimi është edhe Shejhul-Islam Ibën Tejmijje, rahimehull-llah.

Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thotë:

???? ?????? ????? ????????? ????????? ????????? ????????????????????? ???????????????

“Kush ka mundësi të therrë kurban e nuk therrë, le tw mos i afrohet musal-lasë (vend i faljes sw namazit tw Bajramit) sonë”. (hadithi është hasen, transmeton Ibn Maxhe).

Dhe thotë:

???? ?????? ?????? ??? ? ?????????? ??????????? ??????????? ??????? ?????? ???
????????? ????????????????

“Kush ka therrë para se ta fal namazin, le ta therrë një tjetër, e kush nuk ka therrur le të therrë”.
(Buhariu dhe Muslimi).

Mirëpo ai që nuk ka që të therrë let mos brengoset sepse për të ka therrur Pejgamberi, sal-lall-
llahu alejhi ve sel-lem, siç tregon Xhabiri, radijall-llahu anhu, nw hadithin qw e transmeton
Ahmed, dhe Hakim i cili thotë se është hadith i vërtetë, e në këtë pajtohet edhe Dhehebi.

Dy: Koha e therrjes e Kurbanit.

Koha e therrjes fillon pas faljes së namazit të bajramit, duke u mbështetur në hadithin të cilin e
transmeton Enesi, radijall-llahu anhu:

?? ??? ??? ?????????????? ??? ??????? ??? ??? ??? ??????????? ?? ????? ?????? ??? ??????????

“Kush ka therrur para namazit, ka therrur për vehte (domethënë për mish), kurse kush therrë
pas namazit, ai ka therrur kurban dhe e ka qëlluar sunnetin e muslimanëve”. (Buhari).

Koha e therrjes vazhdon deri në ditën e fundit të teshrikut, pra deri në ditën e 13 të muajit
Dhulhixhxe, (dita e katwrt, dita e fundit e Bajramit), kështu që ditët për të therrur kurban janë
katër ditë, duke u mbështetur në hadithin e Xhubejr ibn Metamit:

(... ??? ?? ????? ?????????? ???)

“Në të gjitha ditët e teshrikut mund të therrish kurbanin”. (Ahmed dhe Darekutni, Ibën Haxher
thotë: senedi është me burra të përpiktë-thikat).

Por pa dyshim qw është më mirë të therret kurbanin në ditën e parë pas namazit të bajramit,
sepse Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë:

?? ????? ?? ????? ?? ?? ?????? ??? ?? ?????? ?? ????? ??????

“Vepra e parë me të cilën fillojmë ditën e sotit (ditën e kurban bajramit), është namazi. Pastaj
kthehemi dhe therrim kurbanin”. (Buhari).

Tre: Forma e therrjes.

Sunnet është që njeriu ta therrë kurbanin me dorën e vet. Nëse është lopë ose dele e shtrinë
ate në anën e majtë, të drejtuar kah Kibleja, e vëndon këmbën në qafën e saj dhe gjatë therrjes
thotë: bismil-lah, All-llahu Ekber, All-llahumme hadha minke ve leke, All-llahumme tekabbel
minni ve an ehli bejti.

Në këtë aludojnë hadithet që do ti përmendim në vijim:

Kur të hyjnë dhjetë ditët e Dhul-Hixhxes i ndalohet atij që dëshiron të therrë kurban ti pret flokët, thonjtë, ose lëkurën derisa ta therrë kurbanin, duke u mbështetur në hadithin e Ummu Selemes, radijall-llahu anha:

??? ????? ?????? ?????? ?????? ?? ????? ??????? ?? ????? ?????? ??????)? ??? ?????? (????? ??????? ?????? ??? ?????)

“Kur të hyjnë dhjetë ditët e Dhul-Hixhxes dhe ndonjëri prej jush dëshiron të therrë kurban mos të prek flokët e as lëkurën e tij”. Në trasmetimin tjetër qëndron: “e as nga thonjtë derisa ta therrë kurbanin”. (Muslim).

Kjo ndalesë vlen vetëm për ate i cili do të therrë kurban, kurse anëtarët tjerë të familjes, siç është gruaja dhe fëmijët, nuk i kaplon kjo ndalesë, sepse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka përmendur vetëm ate që dëshiron të therrë kurban, e jo edhe ata për të cilët therret kurban.

Nëse ndokush i pret floket ose thonjtë me qëllim gjatë këtyre ditëve, kjo nuk e ndalon nga therrja e kurbanit, as që kërkon shpagim, mirëpo duhet të pendohet tek All-llahu, subhanehu ve teala, për këtë gabim.

Shtatë: Kurban për të vdekurin.

- Therrja kurban për të vdekurin në shenjë sadakaje nuk është sunnet, kjo sepse Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem i pat vdekur xhaxhai i tij, Hamza; gruaja e tij Hadixheja, tre vajzat e martuara, tre fëmijë të vegjël, e për asnjërin prej tyre nuk ka therrur kurban. Po të ishte gjë e pëlqyeshme ai do të therrte për ta.

- Por nëse i vdekuri ka lënë vasijet (testament, porosi) që të therret për te kurban, atëhere mundet, sepse vasijeti i të vdekurit duhet zbatuar.

All-llahu e di më së miri.

Përpiloi: [Bekir Halimi](#)